

# “LIMESTONE PRODUCTION” SHPK

## AKT THEMELIMI

PER

**SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 10/01/2024 në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “PER TREGTARET SHOQERITE TREGTARE”, në bazë të kushteve që vijnë;

*Themeluesit:*

1. Mirgen Dervishi, atësia Gëzim, lindur në Lushnje, më datë 05.12.1985, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 7, Bulevardi “Gjergj Fishta”, P. 138, H. 1, Ap. 26, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BE3825478, dhe Nr. Personal I51205043G,
2. Mirjan Beneja, atësia Lili, lindur në Korçë, më datë 04.04.1980, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 5, Rruga “Osman Myderizi”, Nd. 2, H. 3, Ap. 48, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BI6392573, dhe Nr. Personal I00404069Q,
3. Lauren Vata, atësia Abdi, lindur në Tiranë, më datë 07.03.1981, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 2, Rruga “Arben Broci”, Banese private Nr. 5, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BA7424361, dhe Nr. Personal I10307146U.

### *NENI 1*

Mirgen Dervishi, Mirjan Beneja, dhe Lauren Vata do të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajnë: “LIMESTONE PRODUCTION” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

- 1- Tregti materiale me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm, makineri e pajisje, lëndë të para ndërtimi, prodhim inertesh etj.
- 2- Import – Eksport i të gjitha llojeve dhe formave.
- 3- Shfrytëzim i mineraleve të grupeve 1,2,3,4, projektim dhe ndërtim minierash dhe karrierash, prodhim i lëndëve të para të ndërtimit, konsulencë, import-eksport mineralesh dhe pajisjesh për minierat e karrierat, transport nacional dhe internacional i mallrave, import eksport, shitje me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm, makineri e pajisje,

lëndë të para ndërtimi, prodhim inertesh etj.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

#### NENI 2

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën : Njësia Bashkiake Nr. 5, Bulevardi “Bajram Curri”, Zona Kadastrale 8260, Pall. 2, H. 1, Ap. 1, Mbi ABI Bank, Tiranë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

#### NENI 3

**KOHEZGJATJA** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

#### NENI 4

**KAPITALI THEMELTAR** i shoqërisë është 100,000.00 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortakët” e shoqërisë:

- 1- Mirgen Dervishi, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 33,330.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë dhe me vlerë të përgjithshme 33,330.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë, që përbën 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2- Mirjan Beneja, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 33,330.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë dhe me vlerë të përgjithshme 33,330.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) lekë, që përbën 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 3- Lauren Vata, zotërues i 1 kuote, me vlerë nominale 33,340.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzetë) lekë dhe me vlerë të përgjithshme 33,340.00 (tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzetë) lekë, që përbën 33.34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrajt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 5

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Elida Beneja, atësia Filat, lindur në Vlorë, më datë 03.03.1980, dhe banues në adresën Njësia Administrative Nr. 5, Rruga "Osman Myderizi", Nd. 2, H. 3, Ap. 48, Tiranë, Shqipëri, me Pasaportë Nr. BF0299811, dhe Nr. Personal I05303170B, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

NENI 6

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin juridik me rregjistrim në "Qendrën Kombëtare të Bisnesit" në bazë të Ligjit 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit" i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

**ORTAKET E SHOQERISE**

**"LIMESTONE PRODUCTION" SHPK**

MIRGEN DERVISHI

Mirgen Dervishi



MIRJAN BENEJA

Mirjan Beneja



LAUREN VATA

Lauren Vata

